



## **Australian Government**

### **Department of Health**

#### **Mbrojtja e komunitetit nga Koronavirusi (COVID-19)**

Ashtu siç po synojmë të jetojmë të sigurt nga COVID (COVIDSafe), me rëndësi është që të qëndroni në shtëpi nëse nuk ndjeheni mirë. Nëse keni të ftohtë apo simptoma të gripit ju duhet të kërkoni këshillim mjekësor që të testohuni për COVID-19. Njerëzit me simptoma të buta akoma mund ta përhapin virusin.

#### **Testimi për COVID-19**

Testimi identifikon nëse pacientët kanë COVID-19 dhe u ndihmon autoriteteve shëndetësore të ndjekin përhapjen e virusit.

Diagnostifikimi i hershëm do të thotë se mund të ndërmerri hapa për të shmangur përhapjen e virusit tek miqtë apo familja. Nëse keni ethe, kollitje, fyt të pezmatuar apo vështirësi në frymëmarrje, është me rëndësi të testohuni.

Testimi është edhe më i rëndësishëm nëse nuk ndjeheni mirë dhe:

- kohët e fundit jeni kthyer në Australi nga jashtë. Të gjithë udhëtarët do të karantinohen për 14 ditë pasi të arrijnë në Australi;
- keni qenë në kontakt të afërt me dikë që është i diagnostifikuar me COVID-19 në 14 ditët e kaluara;
- jeni punëtor shëndetësor, punëtor që kujdeset për të moshuarit apo punëtor shëndetësor reident apo personel me kontakt direkt me pacientë.

#### **Ku mund të testohem?**

Mund ta kontaktoni mjekun tuaj për të organizuar testim apo mund të shkoni në klinikë për sëmundje respiratore. Nëse vizitoni mjekun tuaj, është me rëndësi të kontaktoni së pari klinikën dhe t'u tregoni atyre për simptomat tuaja. Kjo do t'i ndihmon atyre të përgatiten për arritjen tuaj dhe të mbrojnë njerëzit e tjerë në klinikë.

Klinikat për sëmundje respiratore janë qendra shëndetësore nëpër vend që fokusohen në testimin e njerëzve me simptoma akute të infeksioneve respiratore. Për të gjetur një klinikë

për sëmundje respiratore, vizitoni [www.health.gov.au/covid19-clinics](http://www.health.gov.au/covid19-clinics). Shteti apo territori juaj mund të ketë klinika shpesh për t'u testuar. Ato mund t'i gjeni përmes uebfaqeve shëndetësore të shtetit apo territorit tuaj.

Nëse testohuni për virusin, duhet të qëndroni në shtëpi për të shmangur kontaktin me njerëz të tjerë. Mund të nevojitet një apo dy ditë për të marrur rezultatet.

Nëse keni simptoma serioze siç është vështirësi në frymëmarrje, ju duhet të thirrni në 000 për kujdes urgjent mjekësor.

### **Ndihmoni në ndalimin e përhapjes**

Për të mbrojtur komunitetet tona, secili duhet të vazhdon të praktikon distancën fizike dhe higjienën e mirë. Sigurohuni të qëndroni 1.5 metra larg nga njerëzit e tjerë dhe qëndroni në shtëpi nëse nuk ndjeheni mirë. Lani duart me sapun dhe me ujë dhe kollitni apo teshtitni në brendësi të krahut tuaj. Të gjithë mund ta bëjmë pjesën tonë të punës për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes së COVID-19.

### **Shkarkoni aplikacionin COVIDSafe**

Nëse veçmë nuk e keni bërë, shkarkoni aplikacionin COVIDSafe për të ndihmuar të mbron familjen, miqtë dhe komunitetin tuaj. Aplikacioni i mbështet zyrtarët e shëndetit publik për të njoftuar njerëzit që kanë qenë në kontakt me dikë që ka koronavirus.

### **Më shumë informacione për COVID-19**

Është me rëndësi të qëndroni të informuar përmes burimeve zyrtare. Vizitoni [www.australia.gov.au](http://www.australia.gov.au), thirrni Linjën për ndihmë për koronavirus në 1800 020 080 ose shërbimin për përkthim dhe interpretim në 131 450.